




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Sipas kërkesës së Zyrës së Kryetarit të Komunës, të dt.26.01.2018, nr.01-2985, për përkrahje financiare të organizimit të garës së skijimit “Kupa e Gjeravicës”, duke u mbështetur në nenin 40.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.31.01.2018, merr këtë:

V E N D I M


PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË ORGANIZIMIT TË GARËS SË SKIJIMIT “KUPA E GJERAVICËS”

- I. Merret Vendimi për përkrahje financiare të organizimit të garës së skijimit “Kupa e Gjeravicës” e cila do të mbahet në Bjeshkët e Belegut me dt.03.03.2018, **në shumën prej 20.000,00 € (njëzetmijëeuro)**.
Mjetet e kërkuara nevoiten për:
- Hapja e rrugës nga bora distanca prej Hidrocentralit deri te Bjeshka e Belegut,
 - Frezimi dhe rregullimi i stazave të skijimit (sigurimi i ratrakut),
 - Transporti i sportistëstëve nga vendtakimi(Restoran Kalaja),
 - Organizimi i koktej në Bjeshkën e Belegut,
 - Organizimi i evenimentit për shpërndarjen medaljeve, kupës dhe mirënjohjeve,
 - Organizimi i darkës solemne për pjesëmarrësit VIP(Kryeministri, Ministra, anëtarë të Federatave të skijimit Shqipëri, Kroaci etj. dhe persona tjerë si donator-investitorë dhe atashe ambasadash).
- II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga të hyrat e bartura të vitit 2017 në vitin buxhetor 2018.
- III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës Deçan.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.
- V. Me vendim njoftohen:
Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
Arhivi i Komunës Deçan.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.I-13/1

Dt.31.01.2018



Kryesuesi I Kuvendit:
Haki Shehaj